



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 485/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 15.11.2019, mori këtë:

## V E N D I M

**PRANOHET** si e bazuar ankesa Anr. 485/2019 datë 14.11.2019, e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosja, me seli në Prishtinë, **URDHËROHET** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) - Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), që 1 fletëvotim në Vendvotimin 0229C/01R dhe 1 fletëvotim në Vendvotimin 0205C/09R, të vlerësohen të vlefshme, dhe të njëjtat ti bashkëngjiten rezultatit përfundimtar të publikuar me datë 07.11.2019.

## A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 14.11.2019, ka pranuar një ankesë Anr.485/2019 nga subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) në të cilën pretendohet se më 13.11.2019 në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), gjatë numërimit të votave në kutitë e votimit 0229C/01R dhe 0205C/09R janë shpallur dy fletëvotime të pavlefshme në kundërshtim me nenin 7 të Rregullës zgjedhore 06/2013, duke përcaktuar kritere shtesë të cilat nuk janë të parapara me dispozitat e rregullës në fjalë. Sipas parashtruesit të ankesës KQZ-ja i ka shpallur të pavlefshme këto dy fletëvotime me arsyetimin se votuesi në rastin e shënjjimit të shenjës “TIK” e cila e ka bazën e fillimit të shënjjimit brenda katrorit dhe se zgjatja e shenjës “TIK” jashtë katrorit në asnjë mënyrë nuk nënkupton se këto fletëvotime duhet të shpallen të pavlefshme nga ana e KQZ-së.

Parashtruesi i ankesës thekson se neni 7 paragrafi 2 i Rregullës Zgjedhore 06/2013 të KQZ-së përcakton qartë kriteret mbi të cilat një fletëvotim mund të shpallet i pavlefshëm, dhe se asnjë nga kriteret të numëruara taksativisht nuk mund të kategorizohen fletëvotimet të cilat janë shpallur të pavlefshme vetëm pse mbarimi i shenjës “TIK” ka dalur jashtë katrorit mbi subjektin politik të cilin ka votuar, dhe se mënyra se si është shënuar fletëvotimi e bënë qëllimin e votuesit të qarte, në përputhje me rregullën 06/2013 të KQZ-së..

Në përgjigjen e KQZ-së, të pranuar përmes email-it, më datë 15.11.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ( KQZ) pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese thekson se nga informatat që kemi marrë nga Qendra e Numërimit dhe Rezultateve, rezultojnë se, gjatë procesit të rinumërimit të vendvotimeve me vendim të PZAP, vendvotimet 0229C/01R dhe 0205C/09R, fletëvotimet të cilat kanë pasur të shenjuar katrorin e 2 subekteve, është shpallur i pavlefshëm. Shenja e votuesit ka qenë tek katrori i subjektit por vija e shenjës ka hyrë mbrenda katrorit të Subjektit tjetër. Kjo ka qenë arsyeja e shpalljes së fletëvotimit të pavlefshëm. Dhe rasti tjetër kur shenja mbrenda subjektit ka kaluar në fushën e subjekteve tjera. Andaj, bazuar në informatat e QNR-së dhe arsyet e lartëcekura, të njejtit konsiderojnë se ankesa është e pabazuar dhe si e tillë duhet të refuzohet.

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe vlerësimit të provave të bashkangjitura, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

#### **Ankesa është e bazuar**

Nga shkresat e lëndës konstatohet se në kutitë e votimeve: 0229C/01R dhe 0205C/09R janë shpallur nga ana e QNR-së 2 fletëvotime të pavlefshme, për shkak se shenja e vendosur tek njëri subjekt ka kaluar apo i ka përshkruar dy subjekte. Si rezultat i këtyre konstatimeve QNR-ja, me rastin e numërimit i ka shpallur të pavlefshme këto fletëvotime.

Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, si palë ankuese ka paraqitur ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1 të LZP-së, brenda afatit ligjor kur ka kërkuar nga PZAP-i, që këto fletëvotime të shpallen të vlefshme sepse të metat apo gabimet të cilat i referohet QNR-ja nuk janë kritere që e bëjnë të pavlefshëm një fletëvotim.

Paneli, me rastin e pranimit të ankesës, përgjigjes në ankesë, ka formuar ekipin hetues dhe ka dërguar në QNR, për të zhvilluar hetime në raport me pretendimet e cekura nga ankuesi. Pas përfundimit të hetimit në QNR, Paneli ka gjetur se qëndron pretendimi i ankuesit se pa të drejtë 2 fletëvotimet e gjetura në kutitë e votimit 0229C/01R dhe 0205C/09R janë shpallur të pavlefshme, pasi që nga ekzaminimi i të njëjtave ka rezultuar se nuk e përmbushin asnjërin kriter të pavlefshmërisë, të njëjtat duhet të llogariten të vlefshme dhe rezultatet e të njëjtave duhet t'i bashkëngjiten rezultatit përfundimtar të publikuar me datë 07.11.2019.

PZAP-i, më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura vendimin e ka bazuar në nenin 119 paragrafi 5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*”, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rezultati që del nga vlefshmëria e fletëvotimeve si në dispozitiv të këtij vendimi, e të bashkangjitura me këtë vendim, duhet të përfshihet në rezultatin e publikuar përfundimtar të shpallur me datë 07.11.2019.

Andaj, Paneli në kuptim të nenit 117, 118 dhe nenit 120 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Anr. 485/2019 më datën 15.11.2019**



***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.***

1. SIMBOLU VETEM NJE subjekt politik  
 Cezarete SA MO JEDAN politik subjekt

2. Simboli me te njehetive  
 NALISE PËT KOSOVIA

<input type="checkbox"/> 111.	<input checked="" type="checkbox"/> PARTIA LIBERALE EGJIPTIANE - PLE	1	2	3	4
<input type="checkbox"/> 112.	<input checked="" type="checkbox"/> PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVES - PDK	5	6	7	8
<input type="checkbox"/> 113.	<input checked="" type="checkbox"/> PARTIA E ASHKALINJEVE PER INTEGRIM - PAI	9	10	11	12
<input type="checkbox"/> 114.	<input checked="" type="checkbox"/> STRANKA DEMOKRATISKE AKCJE - SDA	13	14	15	16
<input type="checkbox"/> 115.	<input checked="" type="checkbox"/> PARTIA KOSOVSKIP SRBA - PKS	17	18	19	20
<input type="checkbox"/> 116.	<input checked="" type="checkbox"/> PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKANLIVE TE KOSOVES - PDAK	21	22	23	24
<input type="checkbox"/> 117.	<input checked="" type="checkbox"/> POKRET ZA GORA - PG	25	26	27	28
<input type="checkbox"/> 118.	<input checked="" type="checkbox"/> NOVA DEMOKRATISKA STRANKA - NDS	29	30	31	32
<input type="checkbox"/> 119.	<input checked="" type="checkbox"/> AAK - <input checked="" type="checkbox"/> PSD - KOALICIONI 100% KOSOVE	33	34	35	36
<input type="checkbox"/> 120.	<input checked="" type="checkbox"/> SLOBODA	37	38	39	40
<input type="checkbox"/> 121.	<input checked="" type="checkbox"/> SAMOSTALNA LIBERALNA STRANKA - SLS	41	42	43	44
<input type="checkbox"/> 122.	<input checked="" type="checkbox"/> NISMA SOCIALDEMOKRATE E ALEANCA KOSOVA E RE	45	46	47	48
<input type="checkbox"/> 123.	<input checked="" type="checkbox"/> JEDINSTVENA GORANSKA PARTIJA - JGP	49	50	51	52
<input type="checkbox"/> 124.	<input checked="" type="checkbox"/> KOALICIJA VAKAT	53	54	55	56
<input type="checkbox"/> 125.	<input checked="" type="checkbox"/> FUJALA	57	58	59	60
<input checked="" type="checkbox"/> 126.	<input checked="" type="checkbox"/> LEVIZIA VETEVENDOSJEI	61	62	63	64
<input type="checkbox"/> 127.	<input checked="" type="checkbox"/> KOSOVA DEMOKRATIK TURK / ARTISI - KDTP	65	66	67	68
<input type="checkbox"/> 128.	<input checked="" type="checkbox"/> PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVES - PREBK	69	70	71	72
<input type="checkbox"/> 129.	<input checked="" type="checkbox"/> PARTIA EUROATLANTISKE E KOSOVES - PEK	73	74	75	76
<input type="checkbox"/> 130.	<input checked="" type="checkbox"/> KOSOVAKI NEVI ROMANI PARTIJA - KNRP	77	78	79	80
<input type="checkbox"/> 131.	<input checked="" type="checkbox"/> INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVES - IRDK	81	82	83	84
<input type="checkbox"/> 132.	<input checked="" type="checkbox"/> ESMIR KASI	85	86	87	88
<input type="checkbox"/> 133.	<input checked="" type="checkbox"/> GRADANSKA INICIATIVA GORE - GIG	89	90	91	92
<input type="checkbox"/> 134.	<input checked="" type="checkbox"/> LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVES - LDK	93	94	95	96
<input type="checkbox"/> 135.	<input checked="" type="checkbox"/> SRPSKA LISTA	97	98	99	100
		101	102	103	104
		105	106	107	108
		109	110		

1. Përzihet VETËM NËJE SËLLIQI POLITIKË  
 OZBISTE SAMO JEDAN POLITICKI STRANAKAT

2. Niveli i votës është i barabartë për të gjithë  
 qytetarët në të gjithë territorin e Kosovës

<input type="checkbox"/> 111. PARTIA LIBERALE EGJIPTIANE - PLE	1	2	3	4
<input type="checkbox"/> 112. PAK PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - PDK	5	6	7	8
<input type="checkbox"/> 113. PAK PARTIA E ASHKALINJËVE PER INTEGRIRIM - PAI	9	10	11	12
<input type="checkbox"/> 114. STRANKA DEMOKRATSKJE AKCJE - SDA	13	14	15	16
<input type="checkbox"/> 115. PARTIJA KOSOVSКИH SRBA - PKS	17	18	19	20
<input type="checkbox"/> 116. PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKALINJËVE TË KOSOVËS - PDOK	21	22	23	24
<input type="checkbox"/> 117. POKRET ZA GORA - PG	25	26	27	28
<input type="checkbox"/> 118. NOVA DEMOKRATSKA STRANKA - NDS	29	30	31	32
<input type="checkbox"/> 119. AAK - PSD - KOALICIONI 100% KOSOVË	33	34	35	36
<input type="checkbox"/> 120. SLOBODA	37	38	39	40
<input type="checkbox"/> 121. SAMOSTALNA LIBERALNA STRANKA - SLS	41	42	43	44
<input type="checkbox"/> 122. NISMA SOCIAL DEMOKRATË E ALEANCIA KOSOVA E RE PARTIA E DREJTËSISE	45	46	47	48
<input type="checkbox"/> 123. JEDINSTVENA GORANSKA PARTIJA - JGP	49	50	51	52
<input type="checkbox"/> 124. KOALICIJA VAKAT	53	54	55	56
<input type="checkbox"/> 125. FJALA	57	58	59	60
<input type="checkbox"/> 126. LEVIJUA VETËVENDOSJE!	61	62	63	64
<input type="checkbox"/> 127. KOSOVA DEMOKRATIK TËRK PARTISI - KDTT	65	66	67	68
<input type="checkbox"/> 128. PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS - PREBK	69	70	71	72
<input type="checkbox"/> 129. PARTIA EUROATLANTIKE E KOSOVËS - PEK	73	74	75	76
<input type="checkbox"/> 130. KOSOVAKI NEVI ROMANI PARTIA - KNRP	77	78	79	80
<input type="checkbox"/> 131. INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS - IRDK	81	82	83	84
<input type="checkbox"/> 132. ESMIR KASI	85	86	87	88
<input type="checkbox"/> 133. QETADANSKA INICIATIVA GORE - QIG	89	90	91	92
<input type="checkbox"/> 134. LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - LDK	93	94	95	96
<input type="checkbox"/> 135. SHKËPSKA LISTA	97	98	99	100
	101	102	103	104
	105	106	107	108
	109	110		